



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(SEKRETARIA)**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2019

Njoftim

Në zbatim të nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; nenit 8 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Brëndshëm të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin Nr. 141, datë 24.12.2008 dhe nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96 datë.16.07.2016, njoftojmë se ditën e Hënë, datë 15.04.2019, ora 10:00 zhvillohet mbledhja e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite :

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Niveleve kufi/pragjet për klasifikimin e gjeneruesve të rinj me sistemin , në Tipin A,B,C dhe D sipas Vendimit të ERE-s Nr. 129, Datë. 04.06.2018, “ Për miratimin e Kodit të Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve” (Drejtoritë Teknike)
2. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSHEE) dhe Furnizuesit (Drejtoritë Teknike)
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “ Rregullores mbi kushtet teknike për instalimin e burimit dytësor të furnizimit me energji elektrike dhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor , me qëllim parandalimin e çrregullimeve në rrjet (Drejtoritë Teknike)
4. Fillimi i procedurës për liçensimin e shoqërisë “SGD Energji” sh.p.k në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Nderfusha”(Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit)
5. Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit Nr.269, dt.21.12.2018 të Bordit të ERE-s “ Mbi lënien në fuqi të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr.97, dt.23.04.2018”Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz”sh.a për vitin 2018, I ndryshuar (Drejtoria e Çmimit dhe Tarifës)

KRYETARI

Petrit Ahmeti